

VENDIM
Nr.40, datë 5.8.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i“““
Veli Budo,	Anëtar i“““
Zija Vuci,	Anëtar i“““
Franc Jakova,	Anëtar i“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i“““
Halil Kopani,	Anëtar i“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i“““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 31.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr .45 Akti që i përket:

KËRKUES:

1. PARTIA BASHKIMI SOCIALDEMOKRAT, dhe deputeti Teodor Laço, të përfaqësuar nga z.Shaqir Rexhvelaj.

2. PARTIA DEMOKRISTIANE, dhe deputeti Zef Bushati, të përfaqësuar nga Z.Arben Gazheli dhe Shqipe Kociu.

SUBJEKT I INTERESUAR :KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga ZZ.Zamira Caka dhe Spartak Braho.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimit datë 24.7.1997 të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, më të cilin vërtetimi apo anulimi i mandatit të deputeteve Teodor Laço dhe Zef Bushati, i është kaluar për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkesave dhe të subjektit të interesuar si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Pas përfundimit të zgjedhjeve të 29 qershorit 1997 të deputetëve të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ka lëshuar Z.Teodor Laço dhe Zef Bushati. Vërtetimet respektivisht nr.1390/31 Prot., dhe nr.1390/32 Prot., datë 21.07.1997 për zgjedhjen e tyre deputetë të Kuvendit Popullor nga lista e mandateve shtesë e subjektit elektorale, Partia Demokratike.

Në seancën plenare të sesionit të parë të Kuvendit Popullor, Komisioni i Mandateve të këtij Kuvendi, pasi ka shqyrtuar mandatet e deputetëve në tërësi, nuk i ka quajtur të rregullt mandatet e deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati dhe i ka propozuar Kuvendit Popullor mosmiratimin e mandateve të këtyre deputetëve. Në po atë seancë plenare, Kuvendi Popullor me votim ka vendosur që çështjen e vërtetimit ose anulimit të mandateve të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati ta kalojë për t'u vendosur nga Gjykata Kushtetuese.

Në paragrafin e dytë të nenit 20 të Ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", thuhet shprehimisht : "Kuvendi Popullor në sesionin e tij të parë zgjedh një komision për shqyrtimin e mandateve të deputetëve. Me propozimin e këtij komisioni, Kuvendi Popullor vërteton ose anulon mandatet e deputetëve".

Kuvendi Popullor duke mos vendosur vetë vërtetimin apo anulimin e mandatit të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati nuk ka kryer detyrën e tij kushtetuese me të cilën e ngarkon dispozita e sipërcituar.

Detyrën e shprehur në ligjin kushtetues për vërtetimin apo anulimin e mandateve, Kuvendi Popullor nuk ka të drejtën t'ia kalojë për shqyrtim një organi tjetër, përfshi këtu edhe Gjykatën

Kushtetuese.

Përfundimisht, Gjykata konkludon se Kuvendi Popullor duhet të kryejë detyrën e tij kushtetuese dhe të marrë një vendim për vërtetimin ose anulimin e mandatit të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati sipas kërkesave të nenit 20 të Ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Gjithashtu, përderisa Z. Teodor Laço dhe Zef Bushati kanë mandatin e deputetit të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Gjykata çmon se ata gëzojnë të drejtën të marrin pjesë në Kuvendin Popullor gjatë shqyrtimit të mandatit të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 e vijues të ligjit nr .7561, datë 29. 4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit datë 24. 7.1997 të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, me të cilin çështja e vërtetimit apo anulimit të mandatit të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati i është kaluar për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese.

2. Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë në seancën më të afërt të radhës të marrë vendim për vërtetimin apo anulimin e mandatit të deputetëve Teodor Laço dhe Zef Bushati.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jemi dakord me vendimin e shumicës për këto arsye:

Çështja duhej të shqyrtohej në themel nga Gjykata Kushtetuese si organ i vetëm që vendos përfundimisht për ligjshmërinë e zgjedhjes së deputeteve.

Në këtë përfundim arrihet nga kuptimi dhe zbatimi i drejtë i dispozitave kushtetuese dhe konkretisht të nenit 20 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 dhe nenit 24 pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992.

Sipas këtyre dispozitave Kuvendi Popullor me propozim të komisionit për shqyrtimin e mandateve të deputeteve, vërteton ose anulon mandatet e tyre. Por, kur ka kontestim për ligjshmërinë e këtyre mandateve, kompetente është Gjykata Kushtetuese, që vendos përfundimisht.

Tiranë, më 5.8.1997

ANËTAR
H. Dakli

ANËTAR
A.Karamuço

ANËTAR
K. Peçi